

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SHOQERIA KONCESIONARE MARINA VLORË" SH.P.K.**

Sot më datë, 10.08.2021 palet e mëposhtme,

- **Marina Di Valona sh.p.k**, person juridik, organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS M01324008A, me seli qendrore në Tiranë, Farkë, Lundër Lobby Home, Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, përballë Qendrës Tregtare TEG, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në datën 24 Janar 2020 (në vijim "Ortaku i Parë"), dhe e përfaqësuar nga administratori Z. Andi Pashaj, lindur më datë 11.01.1994, identifikuar me letërnjoftim me nr.personal J401110791, me shtetësi shqiptare; dhe
- **Marina Projects Limited**, person juridik, shoqëri e themeluar në Angli, me numër regjistrimi 04182366, me seli qendrore në Suite 8 Bourne Gate, 25 Bourne Valley Road, Poole, Dorset, BH12 1DY, Angli (në vijim "Ortaku i Dytë"), përfaqësuar nga Z. Geoff Phillips, përfaqësuar me prokurë nga Z. Xhet Hushi lindur më datë 04.06.1986, identifikuar me letërnjoftim me nr.personal I60604071R, me shtetësi shqiptare;
- **Brunes. sh.p.k**, person juridik, organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS K37125203H, me seli qendrore në: Durrës, Xhafzotaj, Godinë dy katëshe (Showroom+Magazinë), përballë Komunës Xhafzotaj, Kati 1, Zona Kadastrale 2574, Nr.Pasurie 163/42, Stacioni Zooteknik Xhafzotaj (në vijim referuar si "Ortaku i Tretë", përfaqësuar nga Z. Geront Çela, lindur më 14.08.1968, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr.personal G80814092M, me shtetësi shqiptare);
- **Ndregjoni sh.p.k**, person juridik, organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS K31329048I me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga Sule Bega, Ndërtesa Nr.32, Hyrja 8 (në vijim "Ortaku i Katërt" përfaqësuar nga Z. Xhetan Ndregjoni lindur më 18.05.1969, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr.034140467, me shtetësi shqiptare; bashkë me Ortakun e Dytë dhe Ortakun e Tretë në vijim referuar kolektivisht si "Ortakët e Tjerë"; Ortakët e Tjerë dhe Ortaku i Parë në vijim kolektivisht referohen si "Ortakët" dhe veç e veç si "Ortaku")


në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar "**SHOQERIA KONCESIONARE MARINA VLORË**" SH.P.K.. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkalidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "**SHOQERIA KONCESIONARE MARINA VLORË**" SH.P.K. (këtej e tutje referuar edhe si "**Shoqëria**").
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në " Lobby Home, Rruga Nacionale, Tirane- Elbasan, Farke, Lunder, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.



Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë: zbatimi i detyrimeve dhe te drejtave koncesionare në lidhje me Kontratën e Koncesionit date 30.07.2021 Nr.repertori 1186 dhe Nr. Koleksioni 235.

Ndërtim, operim dhe transferim tek autoriteti kontraktor ne perfundim te Kontratës e Koncesionit date 30.07.2021 Nr.repertori 1186 dhe Nr. Koleksioni 235, te nje porti turistik te jahteve "Marina Vlore", ne protin e Vlores, Vlore.

Ofrimin e shërbimeve: parkim sezonal, parkim i zgjatur dimeror, parkim i zgjatur vjetor, si dhe cdo shërbim tjetër Portual sipas legjislacionit ne fuqi ne perputhje me objektin e kontrates.

Neni 5 – Kapitali themeltar


- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1000 LEK (një mijë lekë), i përbërë nga 4 (katër) kuota.
- 5.2 Ortakët e Shoqërisë janë si më poshtë:
 - **Marina di Valona sh.p.k** është pronar i kuotës që përfaqëson 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - **Marina Projects Limited ltd** është pronar i kuotës që përfaqëson 10% (dhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - **Brunes. sh.p.k** është pronar i kuotës që përfaqëson 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - **Ndregjoni sh.p.k** është pronar i kuotës që përfaqëson 10% (dhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 5.3 Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.
- 5.4 Çdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote. Secila votë ka vlerë përpjesëtimore të njëjtë me kuotën të cilën përfaqëson.
- 5.5 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
 - **Marina di Valona Sh.p.k.**, ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 300 LEK (treqind lekë).
 - **Marina Projects Limited ltd**, ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 100 LEK (një qind lekë).
 - **Brunes. sh.p.k** ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 500 LEK (pesëqind lekë).
 - **Ndregjoni sh.p.k** ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 100 LEK (njëqind lekë).

Neni 6 –Transferimi i Kuotave

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.

Neni 7 – Administratori/ët

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.



- 7.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
 Znj. Eranda Muskaj shtetase shqiptare, lindur me datë 2 Qershor 1990, në _____ madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar e cila emërohet në këtë detyrë për një periudhë prej 5 vjetësh, me te drejtë ripërtëritje.

Neni 8 – Dispozita të Fundit

- 8.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Palët deklarojnë se ky Akt Themelimi, është në përputhje me vullnetin e tyre dhe për këtë arsye e nënshkruan atë në datën e sipërshtuar, me vullnet të plotë dhe të lirë.

Ortaku i Parë
Marina Di Valona

Përfaqësuar nga:
 Andi Pashaj

ANDI PASHAJ



Ortaku Dytë
Marina Projects Limited

Përfaqësuar nga:
 Xhet Hushi

Xhet Hushi

Ortaku i Tretë
Brunes.

Përfaqësuar nga:
 Geront Çela

Geront Çela

BRUNES sh.p.k
 K37125203H
 Durres - Albania

Ortaku i Katërt
Ndregjoni

Përfaqësuar nga:
 Xhetan Ndregjoni

XHETAN NDRREGJONI

"NDRREGJONI"
 A.1
 K313290481
 Tirane Albania